

Vendimi Nr.58/23
Datë: 26.06.23

Duke u bazuar në nenin 26, 27 dhe çështjet procedurale të përcaktuara sipas Nenit 11,13,15,16,17,18,35,51 dhe 55 par 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 26.06.2023, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve Puratos NV (blerës), dhe Z. Bashkim Zeka (shitës) për blerjen e 51% të Aksioneve mbi ndërmarrjen Korabi Corporation (targeti).

Puratos NV, është kompani e inkuorporuar, në pronësi 100% të Puratos Group e cila funksionon sipas ligjeve të Mbreterisë së Belgjikës, me adresë të regjistruar në; Industrialaan 25 1702 Dilbeek, Belgjikë, me numër të biznesit 0438.632.416.

Korabi Corporation Sh.p.k., është kompani private, me adresë të regjistruar në; Llapnasellë pn., Graçanicë, Kosovë me numër unik identifikues 811374941, është në pronësi të personit fizik Z. Bashkim Zeka, me numër personal të identifikimit 1004145964, i cili mbanë 100% të aksioneve në Korabi Corporation Sh.p.k.

Korabi Corporation, ka lidhur një marrëveshje të distribuimit me një kompani e cila është në pronësi të Puratos Group, përkatësisht Puratos d.o.o., e cila është një kompani e inkuorporuar dhe që operon sipas ligjeve të Republikës së Serbisë, me adresë të regjistruar në Dobanovacki 58, 11080 Beograd, me numër të regjistrimit të biznesit 17116657 (**Puratos Serbia**). Produktet të cilat prodhohen nga nga Puratos NV ose nga ndonjëra nga kompanitë e ndërlidhura të Puratos Group nën markën e tij globale (si p.sh Puratos ose Belcolade) janë të pranishme tregun e Kosovës përmes Korabi Corporation, e cila importon dhe ua shet kompanive të ndryshme të regjistruara në Kosovë.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksen administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja tre mijë Euro.

Arsyetim

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 19.05.2023, me Nr. Prot. 224/23-01/H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit përmes Përfaqësuesit Ligjor Z. Mentor Hajdaraj, nga Shoqëria e Avokatëve RPHC Law L.L.C lidhur me blerjen dhe marrjen e kontrollit të Korabi Corporation Sh.p.k., nga Puratos NV.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 01.06.2023.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë. 26.05.2023
4. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjen/Letër Qellimin të lidhur ndërmjet palëve Puratos NV (blerësi), dhe Z. Bashkim Zeka (shitësi), mbi Korabi Corporation Sh.p.k. (targeti).

Baza juridike;

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c) Qarkullimi i palëve në tregun brendshëm e kalon shumën 3,000,000 Euro.
- d) Puratos NV do të blej 51% të aksioneve mbi Korabi Corporation Sh.p.k.
- e) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë 31.03.2023.
- f) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se targeti është kompani e Kosovës, ndërsa, blerësi është prezent përmes shitjeve.

Vlerësimi i Konkurrencës;

Tregu Relevant: Struktura e kompanisë Korabi Corporation nuk do të ndryshoj në tregun përkatës në Republikën e Kosovës.

Tregu i produktit – shitjen e produkteve/përbërësve, që përdoren në furrë buke, pastiçeri dhe prodhimeve të çokollatës.

Tregu gjeografik – tregu i Republikës së Kosovës.

Tregjet e prekura;

Ndërmarrjet në këtë transaksion, janë në treg të njejtë të produktit, mirëpo për shkak se ndërmarrjet respektivisht, blerësi është prodhues ndërsa targeti nuk prodhon por është

vetem distributor i blerësit (vertikale) nuk mund të shkaktoj ndonjë çrregullim në tregun përkatës. Tregu i produkteve/përbërësve të cilët përdoren në industrinë e furrës, pastičerisë dhe çokollatës në Kosovë karakterizohet me shkallë të ulët të përqendrimit në treg, pasi që në treg kemi një numër mjaftë të madh të prodhuesve vendor të cilët mirren me prodhimin e lëndës së parë të këtyre produkteve, në anën tjetër kemi edhe konkurrencë të fortë mes prodhimit vendor dhe importit të këtyre produkteve dhe si i tillë tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga transaksioni.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar, do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës, kërkesa për Njoftim të Përqendrimit është bërë për arsye se, pala (targeti) është kompani vendore, ndërsa blerësi realizon shitje në Kosovë përmes targetit i cili është edhe Distributor i Autorizuar për Kosovë. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit, nuk vërehen mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës, në treg.

Shënim;

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI


Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva